



UNIVERSITETI "KADRI
ZEKA" UNIVERSITY GJILAN
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY PRIZREN
Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren
www.uni-prizren.com tel: 0 29- 232 140



UNIVERSITETI "HAXHI
ZEKA" UNIVERSITY PEJE
UÇK pa nr., 30000, Pejë, Kosovë
www.unhz.eu tel: 039421739

SYLLABUS – Programi Master “Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike”

Lënda: Bashkëpunimi ndër-komunal dhe rajonal

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Bashkëpunimi ndër komunal dhe rajonal
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë, semestri i I-rë
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime Asistent:
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
Detajet kontaktuese:	Dukagjin.leka@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë një studim të bashkëpunimit komunal dhe rajonal. Si struktura institucionale, ashtu dhe korniza ligjore në fuqi krijimin e këtij bashkëpunimi në nivel të mbrendshëm e poashtu edhe rajonal, -- duke përfshirë këtu dhe një analizë kritike të përshtatshmërisë së strukturës aktuale institucionale dhe zbatuese të këtij bashkëpunimi, -- paraqesin thelbin e përmbajtjes dhe të interesimit të kësaj lënde. Përveç paraqitjes së kornizës ligjore dhe institucionale të komunave në Kosovë dhe të sistemeve rajonale të komunave, kjo lëndë po ashtu synon ekzaminimin e zhvillimit të

	diskursit dhe lëvizjeve pozitive që janë bërë për bashkëpunim në mes komunave në nivel vendi dhe më gjerë.
Qëllimet e lëndës:	Duke pasur parasysh zhvillimin e bashkëpunimit të niveleve komunale – komunave në nivel vendi, e poashtu edhe në nivele rajonale dhe më gjerë, si dhe duke e ditur faktin se sot shumica e universiteteve të njohura ndërkombëtare në botë kanë lëndën Bashkëpunimi ndër-komunal dhe rajonal si lëndë të veçantë në studimet Master, edhe ne si Fakultet Juridik i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan e kemi parë mëse të nevojshme që kjo lëndë të futet në kurrikulën mësimore të Fakultetit Juridik, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan. Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që ti bëjë të mundur studentëve që të kuptojnë dhe spjegojnë origjinat intelektuale, kuptimin dhe zhvillimin e diskurseve dhe të lëvizjeve pozitive që kanë ndodhur në krijimin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe rajonal, si në aspektin historik, e poashtu edhe atë përmbajtësor. Qëllimet e tjera të lëndës Bashkëpunimi ndër-komunal dhe rajonal është një rrugë e rëndësishme për komunat në lidhje me ofrimin efikas dhe efektiv të shërbimeve. Komunat gjithandej performojnë funksione qenësore të cilat përcaktojnë cilësinë e jetesës së qytetarëve si dhe mirëqenien kolektive, sikurse janë: rrugët dhe trafiku, transporti, furnizimi me ujë, shkollat dhe foshnjoret, qendrat e shëndetit, hapësirat sportive, mbledhja e mbeturinave, muzetë, teatrot dhe qendrat muzikore, madje edhe varrezat.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Përfundimisht, struktura e kësaj lënde është e organizuar në një mënyrë që në thelb përfshinë tri kategori kryesore, dhe ka për qëllim: (1) Së pari, të ofrojë një hyrje konceptuale për komunat dhe zhvillimin e tyre; (2) së dyti, të paraqesë

	dimensionin institucional të funksionimit të komunave dhe krijimit të bashkëpunimit në mes tyre, dhe (3) së treti, të analizojë dhe studiojë çështje, raste dhe bashkëpunime të suksesshme ndër-komunale, rajonale edhe më gjerë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15 min	4	1
Kollokfiume,seminare	20	1	20
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	1	3
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	1	1	1
Totali			120 orë= 4 ECTS (120:25=4.8)
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive të ilustruara me prezantime nëpower point, seminare, debate dhe punë grupore rreth çështjeve specifike (analiza dhe diskutime), teste vetëvlerësimi, punë interaktive, punë grupore, mësim duke punuar dhe përsëritur.		
Metodat e vlerësimit:	Bazohet në teste, vijueshmëri dhe detyra. Studentët duhet që të arrijnë mbi 50% të notës përfundimtare për kalueshmëri. Testi i parë: 25 pikë Testi i dytë: 40 pikë Detyrat e shtëpisë: 25 pikë (detyra x pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 100 pikë Totali: 100 pikë.		

	Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Prof. Dr. Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011. Kurtesh Saliu, E drejta Kushtetuese (Kapitulli për Vetëqeverisjen Lokale), Prishtinë, 2001. Doracak për nismat e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, Prof. Ass. Dr. Kadri Kryeziu, Vetëqeverisja Lokale (cikël leksionesh), Prizren, 2015 Prof. Ass. Dr. Kadri Kryeziu, E Drejta Kushtetuese e Krahasuar, Prizren 2017 Bowman, Ann O'M., and Richard C. Kearney. State and local government. Cengage Learning, 2012. Hilaire Barnett, Constitutional and Administrative Law, Cavendish Publishing, 2002.
Literatura shtesë:	
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Diskutim për Syllabusin. Diskutim hyrës për qeverisjen lokale dhe rolin e saj në zhvillimin demokratik
Java e dytë:	Qeverisja dhe Demokracia
Java e tretë:	Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë Komunat dhe bashkëpunimi i tyre
Java e katërt:	Asociacioni i Komunave të Kosovës Roli dhe mënyra e funksionimit - kompetencat
Java e pestë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore dhe në Kosovë Konfigurimi i bashkëpunimit rajonal Pse duhet komunat të bashkëpunojnë? Ndërkombëtarizimi i komunave Projektet ndërkombëtare Nismat rajonale
Java e gjashtë:	Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Serbi

	Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Malin e Zi Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Shqipëri Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Maqedoni Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë Krahasueshmëria në mes këtyre shteteve
Java e shtatë:	Testi Mes-semestral
Java e tetë:	Vetëqeverisja lokale në Evropë Karta Evropiane për vetëqeverisje lokale Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Kroaci Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Praktikat e mira Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Slloveni Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Praktikat e mira Baza ligjore e vetëqeverisjes lokale në vendet perendimore të UE-së Vendet Skandinave Komunat dhe bashkëpunimi i tyre Praktikat e mira
Java e nëntë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore - Fusha e zhvillimit ekonomik dhe social Komisioni për Investime i Evropës Juglindore (SEEIC) – Sarajevë Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore - CEFTA 2006, Bruksel Rrjeti Shëndetësor për EJT (SEEHN) – Shkup Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SEE RDSWG) – Shkup
Java e dhjetë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore - Transporti dhe infrastruktura Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) - Sekretariati në Vjenë Observatori i Transportit për Evropën Juglindore (SEETO) – Beograd Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (ECAA) – Bruksel
Java e njëmbëdhjetë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Drejtësia dhe punët e brendshme Nisma Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI) - Shkup Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) – Sarajevë Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore

	(SELEC) – Bukuresht
Java e dymbëdhjetë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Bashkëpunimi për çështje të sigurisë Nisma për Përgatitje dhe Parandalim ndaj Katastrofave (DPPI) – Sarajevë Konventa për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore (PCCSEE) – Lubjanë RACVIAC/ Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Evropën Juglindore – Rakitje, Zagreb
Java e trembëdhjetë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Ndërtimi i kapitalit njerëzor Task Forca e RCC-së për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor – Vjenë Nisma për kërkime arsimore në Evropën Juglindore (ERI SEE) – Beograd Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) – Danilovgrad
Java e katërbëdhjetë:	Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Bashkëpunimi parlamentar Kryetarët e Parlamentit të shteteve të SEECP-së Sekretariati Rajonal për Bashkëpunim Parlamentar në Evropën Juglindore (RSPC SEE) – Sofje COSAP-Konferenca për Ballkanin Perëndimor e Komisioneve Parlamentare të Integritetit Evropian të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit Forumi Parlamentar i Cetinës (CPF) – Podgoricë
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi përfundimtar
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studenti është i obliguar të vijojë ligjëratat dhe ushtrime, nëse studenti nuk vijon mësimin me rregull (mungon më shumë se tri here atëherë nuk merr nënshkrimi. Kopjimi është i dënueshëm. Vlejnë kodi i mirësjelljes si për studentët ashtu edhe për mësime dhënësin.	